

**VENDIM I KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË  
"JOY TRAVEL"Sh.A.**

Në Tiranë, sot në datë 10.12.2015, në selinë e Shoqërisë "Joy Travel", Shoqëri e formuar sipas ligjislacionit Shqiptar, "Këshilli Mbikqyrës" i Shoqërisë, thirri dhe zhvilloi, mbledhjen e tij.

Të pranishëm në mbledhje ishin:

1. Z.Emin Barçi, Kryetar i Këshillit Mbikqyrës,
2. Z. Kristino Kromidha Anëtar i Këshillit Mbikqyrës,
3. Z. Florjan Peri, Anëtar i Këshillit Mbikqyrës,
- 4 Z. Rudina Kashari, Administratore e Shoqërisë,

Rendi i ditës :

- Saktësim/shtim në objektin e Shoqërisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës Z. Emin Barçi.

Pasi u lexua raporti argumentues i Administratores së Shoqërisë znj. Rudina Kashari, mbështetur në Statutin e Shoqërisë "Joy Travel" Sh.A, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Këshilli Mbikqyrës pas shqyrtimit të pikës së rendit të ditës,

**V E N D O S I:**


1-Të miratojë saktësimin/shtim në objektin e Shoqërisë, me tekstin si më poshtë:

" Agjenci Transporti Ndërkombëtar Udhëtarësh"


2-Vendimi i Këshillit Mbikqyrës t'i paraqitet "Asamblesë së Aksionerëve" për miratim.

**KËSHILLI MBIKQYRËS**

**Emin Barçi**



**Kristino Kromidha**



**Florian Peri**



**VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË  
“JOY TRAVEL” SH.A.**

Në Tiranë, sot në datë 11.12.2015, në selinë e Shoqërisë “Joy Travel” Sh.A., Shoqëri e formuar sipas ligjislacionit Shqiptar, u mbledh Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë, e përbërë nga Znj. Xhoana NANO, Aksioner i Vetëm.

Të pranishëm në mbledhje ishin:

1. Znj. Rudina Kashari, Administratore e Shoqërisë
2. Znj. Margarita MATAJ, Financiere e Shoqërisë

Rendi i ditës:

- Miratimi i Vendimit të Këshillit Mbikqyrës, për saktësimin/shtim në objektin e Shoqërisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Aksionerit të Vetëm të Shoqërisë, Znj. Xhoana NANO.

Pasi u lexua raporti i Këshillit Mbikqyrës, mbështetur në Statutin e Shoqërisë “Joy Travel” Sh.A, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Aksioneri i Vetëm, pas shqyrtimit të pikës të rendit të ditës,

**V E N D O S I:**

- 1- Miratimin e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës për saktësimin/shtim objektin e Shoqërisë, si më poshtë:

“ Agjenci Transporti Ndërkombëtar Udhëtarësh”

2- Ngarkohet Administratorja e Shoqërisë Znj.Rudina Kashari, që në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.09.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit”, neni 43, pika 3, gërma “a” dhe pika 4, të depozitojë pranë Q.K.R:

- Vendimin e Këshillit Mbikqyrës, datë 10.12.2015
- Vendimin, datë 11.12.2015, të Asamblesë së Aksionerëve.

**AKSIONERI I VETËM I SHOQËRISË  
“JOY TRAVEL” SH.A**

**Znj. XHOANA NANO**

*Xhoana Nano*

